



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 848/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Nenad Lazić kryesues, Xhevdet Abazi, dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ramadan Tahiri, kandidat për Asamble Komunale nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan, paraqitur kundër Dardan Hasanmetaj - kryesues i vendvotimit në Strelc të Deqanit, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 13.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e pas afatshme ankesa e Ramadan Tahirit, kandidat për Asamble Komunale në subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12.11.2013, nga Ramadan Tahiri, kandidat për Asamble Komunale LDK dega në Deçan, në të cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit QV 0105 C/08D pas numërimit të votave për kandidatin e Asambles Komunale nga rradhët e LDK-së kanë qenë 11 vota të vleshme, të cilat nuk janë qitur në formularin e rezultateve të kandidatëve FRK, ku zyrtarisht figuron 0 vota. Prandaj kërkoj rishikimin e kutis së lartcekur. Parashtrusi i ankesës e ka bashkangjitur deklaratën e KKZ-së të datës 07.11.2013.

PZAP-i, pasi shqyrtoi afatshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pas afatshme

Me ankesën e parashtruar nga Ramadan Tahiri – Kandidat për Asamble Komunale nga subjekti politik LDK dega në Deçan, ka pretenduar se, në QV nr. 0105 C/08D gjatë numërimit mu janë keqpërdorur votat, të cilat nuk janë qitur në formularin e rezultateve të kandidatëve FRK.

PZAP-i, pasi shqyrtoi ankesën konstatoi se, ankesa, është e pas afatshme pasi që,nga shkelja e supozuar ankesa nuk është dorëzuar në në afatin e rregullt ligjorë deri me datë 04.11.2013,që nënkupton se e njëjta është dorëzuar tetë ditë pas afatit, prandaj PZAP-i, në mbështetje të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 848/2013 më datën 13.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Nenad Lazić**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.